Republika e Kosovës

Komuna e Istogut

KONTRATË PËR PËR FURNIZIM

KOMUNA E ISTOGUT-Njësia e Prokurimit, të cilën e përfaqëson menaxher-i, Gëzim Ademaju, Adresa Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë;

dhe

"HARISI GROUP" SHPK nga Prishtina, të cilën e përfaqëson z. Masar Kabashi, ne cilësinë e drejtorit të ndërmarrjës me nr. te Rexh. Biznesit 810878928 (ne vazhdim "Furnizuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për furnizimet e shënuara me poshtë:

INVENTARIZIMI I QENDRES SE PARAGLLAJDIZMIT -LOT 2

Nr. I prokurimit	**633-20-7108 -1-2-1/C433 – LOT 2**
Nr. I brendshëm	**633 / 020 / 120 / 121**

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë:

INVENTARIZIMI I QENDRES SE PARAGLLAJDIZMIT -LOT 2

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 20. DITË pas porosisë se Autoritetit Kontraktues. nga dita e nënshkrimit të kontratës dhe të lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jenë Qendra e Paragllajdizmit ne - Istog

2.3 Inkotermi1 i zbatueshëm do të jetët *DDP*

Neni 3 Origjina

3.1Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjën e kontratës.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimet total i kësajë kontrate për pagesë është: **3.987,50 €**

"Tremimijëenëntëçindetetëdhjetëeshtatë-50/100

4.2 Kjo pagesë është e vetmja qe AK-ja ka borgj ndaj kontraktuesit.

4.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5. Kohëzgjatja e kontratës:

5.1. Te gjitha furnizimet sipas kësajë kontrate do të fillojnë menjeherë pas nenshkrimit te sajë dhe do të përfundojnë me datë 22. 12. 2020

Neni 6. Ndërprerja e kontratës:

6.1 Kjo kontratë mund të shkëputet kurdo që kontraktori nuk i respekton kushtet e përgjithshme dhe te veqanta te kontratës te parapara ne dosjen e tenderit, dhe kur per një gje te tillë plotesohen këto kushte, duke pas parasysh edhe sanksionet e parapara per dëmet qe eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktues.

Neni 7 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

7.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Kjo marrëveshje e kontratës;

Kushtet e Veçanta të Kontratës;

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;

Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;

Oferta financiare;

Plani per menaxhimin e kontratës

7.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 8 **Komunikimet**

8.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht

8.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

8.3 Kurdo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe **fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose"vendosë "do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.**

8.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe dhe serbe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues: **Komuna e Istogut**		*Për Kontraktorin:* **"Harisi Group" shpk**	
Emri:	***Gëzzim Ademaj***	***Emri:***	***Masar Kabashi***
Pozita:	***U.D. I Menaxheri-t të Prokurimit***	***Pozita:***	***D r e j t o r***
Nënshkrimi:		***Nënshkrimi:***	
Data:	08. 12. 2020	***Data:***	08.12.2020
Vula		***Vula***	

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E ISTOGUT OPŠTINA ISTOG REPUBLIKA KOSOVO

SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR HARISI GROUP

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë : GJUHA SHQIPE.
Siguria e ekzekutimit	9.1	10 % E VLERES SE KONTRATES ME VLEFSHMERI 30 DITE ME GJATE SE PERFUNDIMI I KONTRATES.
Sigurimi	10.1	OE PERMES SIGURIMIT TE EKZEKUTIMIT SIGURON PER CILESIN E PRODUKTIT
Tatimet dhe marrëveshjet doganore	12.1	*TE GJITHA TATIMET DHE DOGANAT PER PRODUKTIN NE FJALE JANE BARRE E OPERATORIT EKONOMIK,AK PAGUAN ÇMIMIN ME TE GJITHA NGARKESAT TE PARAQITUR NE FORMULARIN E TENDERIT*
Cilësia e furnizimeve, puneve	18.2	*GARANTON FURNIZUESI(OE)*
Inspektimi dhe testimi	19.2	*INSPEKTIMI DHE TESTIMI DO TE BEHET NGA KOMISIONI I CILI DO TA VERIFIKOJ DHE PRANOJ PRODUKTIN.*
Pagesa	20.1	Pagesat do të bëhen;PAS PRANIMIT TE MALLIT GJEGJESISHT PAS RAPORTIT TE PRANIMIT TE NENSHKRUAR NGA KOMISIONI PER PRANIM.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2.	*MOSMARRVESHJET DO TE BEHEN PERPJEKTKE PER ZGJIDHJE MIQESORE NE MES PALEVE NENSHKRUESE TE KONTRATES*
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet NË GJYKATEN THEMELORE-DEPARTAMENTI PER QESHTJE EKONOMIKE

Për: **KOMUNA E ISTOGUT**

Adresa: ***Fadil Ferati, nr.121***

Titulli I Kontratës ***INVENTARI I QENDRES PER PARAGLAIDING***

Viera:

PARAMASA DHE PARALLOGARIA: STANI

Në çmim duhet të parashihet blerja, furnizimi, punimi/montimi i çdo materiali me pozicionim sipas projektit dhe testimi i materialeve te nevojshme para lëshuarës ne pune. Sistemimi i materialeve, pastrimi i punishtes nga mbeturinat gjatë dhe pas kryerjes se punimeve. ***Verejtje-*** *Invertari duhet te dergohet ne pikën e paraglidingut Shymek -Istog ne lartesin mbi detar 1700 m ne distanc 18 klm rrugë malore .*

A: PUNËT NDËRTIMORE DHE ZEJTARE

1	**PUNËT E DHEUT DHE FURNIZIMIT ME GYPIN E UJIT DHE PUSETA**				
1.1	Heqja e shkurreve, pastrimi i terrenit ndërtimor (sipas nevojës)	m^2	150	0.25 €	37.50 €
1.2	Gërmimi i dheut (kategoria I - II shkëmbore) me makinë apo me dorë ne thellësi prej 50 cm nga kroi afër Qendrës së Paraglidingut e deri te stani .	m	300	1.00 €	300.00 €
1.4	Furnizimi, shtrirja e gypit të ujit PVC - 3/4 nga kroi afër Qendre e deri te stani dhe kabina e WC-së , mbushja e kanalit me trashësi t=50cm me ngjeshje të mirë .	m	300	2.00 €	600.00 €
1.5	Furnizimi dhe montimi I lidhëse pvc 3/4 ne tri degëzime dhe ne dy lidhjet ne dalje te ujit tek stani .	cope	10	6.00 €	60.00 €
1.6	Furnizimi dhe vendosja e dy puse tave PVC me dimensione 60 x 60 njëra tek furnizimi i ujit ne gyp dhe tjetra te vendoset afer stanit ku behet degëzimi i ujit për stan dhe për WC .	cope	2	95.00 €	190.00 €
1.7	Furnizimi dhe vendosja e një pusete nga betoni me dimensione 80 x 80 x 100 cm ku paraprakisht te hapet gropa për puset dhe vendoset një bazament për nivelim te pesetës me beton dhe gur natyral , pastaj vendosim pllakën mbi puset ku behet ankorimi i konstruksionet i WC - kabinës.	cope	1	250.00 €	250.00 €
	Total poz. 1				**1,437.50 €**



2	**PUNËT E ZDRUKTHËTARISË (Inventari)**				
	Furnizimi dhe montimi i një kuzhine mobile me dimensione jo me te vogla se 60 x 120 cm me elementë : një lavo bo me elemente përcjellëse , një dollap i lart një dollap i poshtëm , krot i ujit .Materiali te jete nga druri natyral .				
2.1	60x120cm (D1)	copë	1	300.00 €	300.00 €
	Furnizimi dhe montimi i një tavoline druri natyral me 8 karrige				
2.2	80 x180 cm (D2)	copë	1	400.00 €	400.00 €
	Furnizimi dhe montimi i tre shtretërve me dy njësi (dy kate) me material druri natyral ne këtë pozicion te përfshihet edhe vendosja e dyshekëve .				
2.3	90 x200cm (D3)	copë	3	300.00 €	900.00 €
	Furnizimi dhe montimi i kaminit me njësi përcjellëse - qynka për vendosje deri mbi nivelin e kulmit . Në këtë pozicion të përfshihet hapja dhe depërtimi i qynkes se oxhakut në kulm si dhe te behet izolimi sipas standardëve te detaji i kulmit .				
2.4	60 x60 x 100 cm (D4)	copë	1	450.00 €	450.00 €
	Furnizimi dhe montimi i kabinës se WC -së nga materiali i konstruksionit - nga metali dhe m veshja me llamarinë .Në këtë pozicion të përfshihet vendosja dhe lidhja me ankora ne pllakën e betonit .				
2.5	90 x 90 x 200 cm (D5)	copë	1	500.00 €	500.00 €
					2,550.00 €

A:	**REKAPITULIMI I PUNEVE NDËRTIMORE DHE ZEJTARE**	
1	PUNËT E DHEUT DHE GYPIT TË UJIT	1,437.50 €
2	PUNËT E ZDRUKTHËTARISË (Inventari)	2,550.00 €
	TOTALI ME TE GJITHA NGARKESAT LOTO2:	**3,987.50 €**

